



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A  
DREJTORIA LIGJORE

Tiranë, më 27.10.2023

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE  
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Hartim i Projekteve të Zyrave Postare”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
Shërbim për projektim ndertesash **71221000-3**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 3,673,845 (tre milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind e dyzetë e pesë) lekë, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **SH.A. Posta Shqiptare**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3, Shuma e sigurimit të ofertës është **73,476.9** (shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë nëntë) Lekë.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre vitet e fundit 2020,2021,2022, **ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro**

**minimale vjetore me vlerë jo më pak se 39% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

*Kerkesa e mesiperme eshte bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure,si dhe mbeshtetet ne në nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43,b*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore.*

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël se 19% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më e vogël se 19% të vlerës limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

**2.3.2** Operatorët ekonomik duhet të disponojnë licensat e nevojshme profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për studim/projektim (leshuar nga MZHUT/MEI) lidhur me ekzekutimin e kontrates ku të përfshihen kategoritë për projektim ne kategoritë si më poshtë (sipas modelit të miratuar me Vendim Të Këshillit të Ministrave nr. 943, datë 28.12.2016):

### **1. PROJEKTUES ARKITEKT**

2 a- Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike. *Eshte kerkuar pasi te gjitha Zyrat postare qe jane pjese e ketij projekti do te kene ndryshime dhe punime ne arkitektur si fasad dhe riorganizim te brendshem. Cdo zyre kerkon ndryshime ku duhet te tregohen dhe vendosja e banakeve per te ndryshuar dhe krijuar hapsira te reja ne zyrat postare.*

2 c- Projektim interiere.

*Eshte kerkuar per te gjitha sallat e Zyrave postare qe jane pjese e ketij projekti do te kete punime interieri. Do te kete riorganizim te sallave te sherbimit dhe ambjenteve ndihmese.*

2 d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.

*Eshte kerkuar pasi ne disa Zyra Postare do te ket dhe projekt per sistemimet e jashtme ne ambjentet qe i perkasin zyrave postare.*

### **2. PROJEKTUES KONSTRUKTOR**

3 a- Objekte civile-industriale–turistike prej murature e skelet betonarme deri në 5 kate.

*Eshte kerkuar pasi ne te gjitha zyrat postare qe do te behet projekti duhet pare dhe ana konstruktive ne qofte se do te ket nevoje per nderhyrje si p.sh prishje murresh për manaxhimin sa më të mirë të hapësirave e cila duhet gjykuar nga inxhinieri konstruktor nëse per vazhdimin e projektit.*

### **3. PROJEKTUES INSTALATOR**

4a- Projektim të instalimeve hidro - termosanitare.

*Eshte kerkuar pasi ne disa Zyra Postare do te ket dhe projekt per regullimin e tualeteve qe te mos jene ne funksion ose kan problematika te ndryshme. Per zyrat postare qe nuk kane tualet kerkohet qe te gjykohet dhe te mundoshet krijimi i tualeteve te reja.*

4b- Projektim të instalimeve termo teknike – kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.

*Eshte kerkuar pasi ne disa Zyra Postare do te ket punime kondidionimi me sitem qendror te vendosura ne tavan e cila perdoret per zyrat qender dhe kondisioner mural qe do te perdoren per zyrat e vogla.*

4f- Projektim i sistemeve kundra zjarrit.

*Eshte kerkuar pasi ne Zyrat Postare ka nevoj per pasjen e nje projekti per vendosjen e hidranteve , sensore terrmk,sirena alermi tabeleve exit etj duke patur parasysh menyren e punes ne keto zyra ku perdoret letra dhe kane arkiv shume vjecare*

### **4. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE**

5b- Projektim furnizim me ujë–kolektorë shkarkimi.

*Eshte kerkuar pasi ne Zyrat Postare do te ket nderhyrje ne te gjitha tualetet ekzistues dhe do te ndertohen te rinj brenda zyrave postare ku duhet te behet projekti i furnizimit dhe shkarkimeve sipas nevojës se zyres.*

### **5. PROJEKTUES ELEKTRIK**

4c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

*Eshte kerkuar pasi ne Zyrat Postare do te ket nderhyrje ne te gjitha linjat elektrike duke ndryshuar linjat e vjetra me te reja dhe duke krijuar linja te reja per te krijuar infrastrukturen sa me te mire dhe per sherbimet e reja qe ofron Posta Shqiptare.*

4j-Projektim i rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e detektimit etj (per objektet civile dhe industriale)

*Eshte kerkuar pasi ne cdo zyre Postare do te behen dhe linjat e reja te internetit dhe linjat ndihmese per funksionimin sa me te mire te sherbimeve duke patur parasysh qe Posta Shqiptare ka shtuar shume sherbimet e saj dhe kjo ben qe duhet te ngrihet nje infrastruktur ndihmese shume me e mire.*

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojmë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transport dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6, gërma a) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 943, datë 28.12.2016

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencat e drejtuesve teknike (inxhinierë) që do të përfshijë për zbatimin e kontratës në kategoritë si më poshtë shënuar :

- 1 (një) inxhinier infrastrukture/ndërtimi/rruga ura
- 1 (një) arkitekt/urbanist
- 1 (një) inxhinier mekanik
- 1 (një) Inxhinier hidroteknik
- 1 (një) inxhinier elektrik/elektroteknik

Për inxhinierët e mësipërm Operatori ekonomik duhet të paraqesë këto dokumenta: licencë profesionale individuale si dhe të jenë të përfshirë në licensën e shoqërisë, kontratë pune të vlefshme, diplomë, cv, librezë pune si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muaj.

*Bazuar ne piken 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “**Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.***

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

#### **1 (një) inxhinier infrastrukture/ndërtimi/rruga ura**

*Eshte kerkuar pasi ne Zyrat Postare qe do te kryhen matjet dhe projektet duhet te shikoj dhe studioj dhe inxhinieri per te gjykuar problematikat qe mund te ket objekti dhe zgjidhjen e tyre.*

#### **1 (një) arkitekt/urbanist**

*Eshte kerkuar pasi ne Zyrat Postare qe do te kryhen matjet dhe projektet duhet te shikoj dhe studioj dhe arkitekti duhet te krijoj hapsira te reja per ti dhene funksionalitet sa me te mire te zyrave postare brenda sallave ashtu dhe ne fasad.*

#### **1 (një) inxhinier mekanik**

*Eshte kerkuar pasi ne Zyrat Postare do te ket vendosje te sistemin te kondicionimit te cilat duhet te shikohen nga inxhinieri per te studiuar hapsiren dhe llogaritur vendosjen dhe fuqin e sistemeve te kondicionimit aspirimit dhe kondisionerave mural.*

#### **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**

*Eshte kerkuar pasi ne Zyrat Postare do te ket punime ne te gjitha tualetet ekzistues*

dhe ku eshte e mundur do te krijohen te reja duke gjykuar per linjat e reja dhe zevendesimin e atyre te vjetrat. Duhet pare te gjitha linjat dhe furnizimi dhe shkarkimi.

### **1 (një) inxhinier elektrik/elektroteknik**

*Eshte kerkuar pasi ne Zyrat Postare do te ket punime ne te gjitha zyrat postare do te behen linjat elektrike te reja dhe linjat e internetit duke ju pershatur me sherbimet e reja dhe ndryshimet qe do te vijn nga projekti.*

**2.3.4** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Korrik 2023 – shtator 2023, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. ***Operatori ekonomik duhet të ketë një numer mesatar prej 8 (tetë) punonjësish të siguruar për periudhën Korrik 2023 – shtator 2023.***

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës Të Vetëdeklarimit (Shtojca 9).*

*Në rastin e shpalljes fitues të Operatorit Ekonomik, para lidhjes së kontratës, Autoriteti Kontraktor do të kërkojë nga OE fitues të paraqes për fuqinë punëtore dokumentacionin (original ose kopje e noterizuar) të sipërcituar.*

**2.3.5** Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë dhe të paraqesë këto çertifikata në përputhje me objektin e prokurimit (të vlefshme ose ekuivalente dhe të akredituara nga DPA ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë):

- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001: 2015 (për sistemin e menaxhimit të cilësisë)**, (e vlefshme) ose ekuivalente,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 (per sistemin e menaxhimit të mjedisit)**, (e vlefshme) ose ekuivalente,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **OHSAS 18001:2007 (për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)**, (e vlefshme) ose ekuivalente,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **BS PAS 99:2012 (për sistemin e menaxhimit të integruar)**, (e vlefshme) ose ekuivalente.



- **Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit ISO 9001:2015 (per sistemin e menaxhimit te cilesise), për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme ose ekuivalente dhe e akredituar nga DPA ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)**

*Ky kriter është përcaktuar për arsye se: ISO 9001 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanimit i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit. Kjo çertifikatë përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.*

- **Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit ISO 14001:2015 (per sistemin e menaxhimit te mjedisit),(e vlefshme) ose ekuivalente,**

*Ky çertifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky çertifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor.*

*Ky kriter është përcaktuar për të krijuar bindje se operatori ekonomik ofertues përmbush standartet e kërkuara në mbrojtje të mjedisit. Angazhimi për mbrojtjen e mjedisit kthehet në një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi kurse metoda më e thjeshtë dhe më efikase për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin është zbatimi i një sistemi menaxhimi për mjedisin në konformitet me parashikimet e standartit ndërkombëtar ISO 14001.*

- **Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit OHSAS 18001:2007 (per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune), (e vlefshme) ose ekuivalente,**

*Ky kriter është përcaktuar për të krijuar bindje se operatori ekonomik ofertues përmbush standartet e kërkuara në mbrojtje të shendetit dhe sigurisë në punë. OHSAS 18001 është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shendetit dhe sigurimit në punë.*

- **Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit BS PAS 99:2012 (per sistemin e menaxhimit te integruar), (e vlefshme) ose ekuivalente.**

*Ky kriter është përcaktuar për të krijuar bindje se operatori ekonomik ofertues zotëron kapacitete teknike në realizimin e kontratës në përmbushje të specifikimeve teknike të kërkuara. Pas 99:2012 është një specifikë publike, lançuar nga BSI (British Standart Institution), me qëllim të ndihmës shoqëritë të integrojnë sa më shumë sisteme të menaxhimit të implementuar (p.sh sistem i menaxhimit të cilësisë implementuar sipas ISO 9001, sistem i menaxhimit të mjedisit ISO 14001 dhe sistemi i menaxhimit të shendetit dhe sigurisë në punë OHSAS 18001.*

**Argumentimi:** Vendosja e kriterëve lidhur me certifikimet ISO bazohet në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për

prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se, Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma çertifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente, konkretisht: Vendorsja e ketyre kriterëve është e bazuar në faktin që certifikatat ISO garantojnë që operatorët ekonomik zbatojnë në punën e tyre procedurën të çertifikuara ndërkombëtare për të garantuar shërbime me kualitet.

**2.3.6** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin se disponon në pronësi ose me qira

- a) 1 Autovetura 4+1

Per kete OE te paraqese:

a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) si dhe certifikaten e transportit, dhe për mjete të siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit dhe certifikaten e transportit (te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontratën përkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë akte të çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

c) *Për mjetet e marra me qeratë të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cili duhet të përshijë afatin e objektit të tenderimit prokurimi.*

d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.9.(Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetin që disponon në **Formularin Përmbledhës Të Vetëdeklarimit (Shtojca 9)**.*

*Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, Autoriteti Kontraktor do t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.*



**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion nje automjet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë 1 (nje) autoveture në pronësi ose më një kontratë qiramarrje të noterizuar për të vërtetuar aftësinë e kryerjes së këtij shërbimi sipas nevojave të AK konkretisht sektorit perkates. Duhet të disponojë dëshmi për automjetin dhe pajisjet sipas Kodit Rrugor për të shmangur çdo parregullsi e cila do të bëhej shkak për mos kryerjen në kohë të shërbimit të kërkuar.

\*\*\*

Kriteret e kualifikimit janë vendosur në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës me qëllim që të vërtetohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet ligjore dhe kualifikimet e nevojshme teknike e profesionale si edhe pervojën e duhur për përmbushjen me sukses të kontratës, objekt i këtij prokurimi, e cila ka një specifikë të veçantë .

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës, i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontraktor, në përputhje me pikën 38 të nenit 4 dhe nenin 36 të Ligjit nr.160/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 41, pika 1 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**